

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SEAN” shpk

Sot, me date 24.06.2021, ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar, respektivisht Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04. 2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i nenshkruari:

Z.TAULANT HOXHA, atesia Kadri, amesia Duhie, i datelindjes 30.09.1972, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, mbajtes i dokumentit te identifikimit *Leternjoftim ID 035237629/ H209301310* me afat deri me 10.12.2029,

si themelues i shoqerise tregtare “SEAN” shpk, sot me date 24 Qershor 2021, duke patur zotesine ligjore per te vepruar, perpilon kete Akt Themelimi, me kete permbajtje si me poshte vijon:

Neni 1:

FORMIMI

Formohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **Shoqeria “SEAN” shpk**.

Neni 2:

SELIA

Selia e Shoqerise Tregtare “SEAN” shpk eshte ne Durres ne adresen: Lagja Nr.16 Rr.Hysen Kertusha”, objekti BIG BAR , Kati 4, Durres, Shqiperi.

Neni 3:

KOHEZGJATJA

Shoqeria Tregtare “SEAN” shpk ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike te pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4:

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “SEAN” shpk do te kete per objekt aktiviteti, si me poshte:

Investim dhe menaxhim në fushen e veprimtarise ndertimore, per ndertimin e çdo lloj objekti dhe per kryerjen e çdo lloj vepre apo punimi me karakter publik apo qe do ti sherbeje interesit publik apo me karakter privat, te natyres civile, industriale, turistike, bujqesore, qendra biznesi, hotele, bar, restorante, investim dhe menaxhim per ndertimin e urave, çeljen dhe perfundimin e rrugeve te reja, çeljen dhe ushtrimin e aktivitetit te agjensive imobilare, investim, menaxhim dhe ndertime mbrojtese e punime sistemimi kunder gerryerjeve lumore, liqenore, import-eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te materialeve te gjithellojshem ndertimore, investime dhe sipermarrje ndertimore per ndertimin dhe menaxhimin e hidrocentraleve dhe TEC-ve, me qellim per te realizuar prodhimin, transmetimin dhe shperndarje te energjise elektrike, si nepermjet

ndertimit te hidrocentraleve te rinj dhe TEC-eve dhe rehabilitimit te tyre, sherbime te ndryshme dhe punime sherbimesh ne te gjitha fushat sipas shperndarjes se energjise, ndertime per N/stacionet, kabinat e trasformatoreve, linjat e TN te ulet, te mesem, te larte, dhe shperndarjen e energjise, eksport, import, shitblerje dhe prodhim te energjise elektrike, ndertime, punime dhe vepra te cfaredolloji qe kane te bejne ndertimin dhe menaxhimin e sherbimeve dhe rrjetit te ujesjellesave dhe kanalizimeve, si mirembajtje, riparim, permiresimin e rrjetit ekzistues te ujesjellesit, hapjen e rrjeteve te reja apo te pikave dhe linjave te reja te furnizimit apo te shperndarjes se ujesjellesit, godinave te administrates, linjave, nenstacioneve, kabinave te ujesjellesit, import, eksport, shitje, prodhim dhe shperndarje te ujrave etj, import, eksport dhe tregtim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, pajisjeve apo makinerive te nevojshme dhe qe i sherbejne ushtrimit te aktivitetit sipas objektit te veprimtarise, artikujve ushqimore, blegtorale, bujqesore dhe te çdo lloj malli tjetër te lejuar per tregtim, marreveshje kontraktore me persona juridike vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit etj.

• Neni 5:

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali Themeltar i Shoqerise eshte ne likuiditet ne shumen: **100.000 Leke** (njqindemije) Leke, i ndare ne **1 kuote** me vlere nominative **1 kuote/100.000 Leke**, i formuar dhe nenshkruar nga Ortaku i vetem themelues sipas ketij kontributi:

- **Ortaku TAULANT HOXHA** kontribues me shumen **100.000 Leke** te barabarta me **1 Kuote** qe zene 100% te Kapitalit, ku nje kuote eshte e barabarte me **1 vote me te drejte vendimore.**

Neni 6:

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese te Shoqerise Tregtare "**SEAN**" shpk jane Asambleja e Shoqerise dhe Administratori i saj.

Fusha e veprimit, perberja dhe funksionimi i organeve drejtuese, emerimi dhe shkarkimi i anetareve dhe çeshtje te tjera te ketyre organeve rregullohen sipas Statutit te Shoqerise, qe eshte pjese perberese e ketij Akti, si dhe me dokumente te tjera te brendshme te shoqerise qe do te miratoje Asambleja e saj.

Neni 7:

Shoqeria Tregtare "**SEAN**" shpk do te administrohet nga 1 (nje) administrator ligjor qe eshte **Z.OLIVER USHINA**, atesia Fiqiri, amesia Kadrije, i dtl. 24.04.1979, lindur dhe banues ne Durres, me shtetesi shqiptare, me arsim te larte, mbajtes i Kartes se Identitetit me numer personal, H90424029E, i cili emerohet per nje periudhe **5 vjeçare.**

Administratori ka per detyre te realizoje administrimin e shoqerise dhe perfaqesimin e shoqerise tek te tretet si dhe ne gjykata, sipas percaktimeve te ketij akti themelimi, statutit, kompetencave te percaktuara ne Ligjin Nr.9901, dt. 14.04. 2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe kompetencave e detyrave te dhena posacerisht nga Asambleja e shoqerise.

Neni 8:

Shoqëria Tregtare “**SEAN**” shpk do të zhvillojë aktivitetin e saj sipas dispozitave normative urdheruese të Ligjit 9901, dt.14/04/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” dhe legjislativitetit tjetër të zbatueshëm sipas llojit të veprimtarisë dhe natyrës së marrëdhënieve juridike, në të cilat kjo shoqëri do të angazhohet.

Neni 9:

VULA E SHOQËRISE

Shoqëria ka vullen e saj zyrtare me përmbajtje: Shoqëria Tregtare “**SEAN**” shpk, Durrës, Shqipëri.

Neni 10:

MARRËDHËNIET E PUNES

Marrëdhëniet e punës në Shoqërinë Tregtare “**SEAN**” shpk rregullohen sipas dispozitave të Statutit të saj.

Neni 11:

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Viti financiar i shoqërisë mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti.

Në mbylljen e çdo viti financiar, Administratori i Shoqërisë bën inventarin dhe llogaritë vjetore, në përputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton një raport me shkrim për administrimin.

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Administratori, i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së shoqërisë brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 12:

Të ardhurat neto pas shlyerjes së detyrimeve fiskale dhe të atyre ndaj të treta, i ndahen ortakeve të shoqërisë në përputhje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themel të shoqërisë.

Neni 13:

PRISHJA E SHOQËRISE

Shperberja e Shoqerise Tregtare "SEAN" shpk, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredolloj shkaku, duke vepruar sipas kritereve te parashikuara ne Statut.

Neni 14:

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Te gjitha kundërshtimet eventuale midis ortakeve te shoqerise, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane. Mosmarreshjet mund te zgjidhen edhe nga nje gjykate brenda apo jashte Shqiperise, ne rast se ortaket kane rene dakord midis tyre.

Neni 15:

NENSHKRIMI

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare ne gjuhen **shqipe**, me permbajtje e vlere te njejta juridike dhe pasi lexohet me ze, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues te Shoqerise tregtare "SEAN" Shpk, z. Taulant Hoxha dhe nenshkruhet prej tij ne te gjithë ekzemplaret, duke u vene emri, mbiemri dhe firma origjinale.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

TAULANT HOXHA

